

FONDACIONI

*Qendër
Shtator*

**TRANSPARENCA
DHE REFORMA
NË DREJTËSI NË SHQIPËRI
Shtator 2022**

Studimi “Transparenca dhe Reforma në Drejtësi në Shqipëri” është përgatitur me mbështetjen e WFD – Westminster Foundation for Democracy.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson detyrimisht pikëpamjet e Fondacionit Qemal Stafa. Fondacioni ka të drejtat e plota të këtij raporti, i cili nuk mund të riprodhohet ose përkthehet i gjithë ose një pjesë e tij pa konfirmim paraprak.

Ekspertët:
Ardita Lafe
Besa Velaj

Shtator 2022

Tabela e Përmbajtjes

1. Reforma në Drejtësi.....	1
2. Faktorët që Kanë Diktuar Reformën në Drejtësi.....	2
3. Procesi i Rivlerësimit në Sistemin Gjyqësor.....	4
3.1 Organet dhe Subjektet e Përfshira në Procesin e Rivlerësimit në Sistemin Gjyqësor....	4
3.2 Rezultatet e Procesit të Rivlerësimit në Sistemin Gjyqësor.....	4
4. Elementët Kyç të Reformës në Drejtësi: Transparenca dhe Integriteti.....	7
5. Transparenca e Organeve të Drejtësisë në Shqipëri.....	10
5.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor.....	10
5.2 Këshilli i Lartë i Prokurorisë.....	11
5.3 Gjykatat.....	12
5.4 Prokuroritë.....	13
5.5 Institucionet e Rivlerësimit	14
6. Gjetjet Kryesore.....	15
Referenca.....	16

1. Reforma në Drejtësi

Reforma në drejtësi është një nga reformat më të thella ligjore dhe institucionale që ka prekur sistemin e drejtësisë dhe jo vetëm, në vendin tonë, në dy dekadat e fundit. Ajo çka e bën këtë reformë të dallueshme dhe shumë të rëndësishme, është ndër të tjera impakti i gjerë që ky proces ka pasur për grupet e interesit që e kanë aktivitetin e tyre të lidhur me sistemin e drejtësisë, por jo vetëm. Impakti i këtij procesi shtrihet më gjerë në shoqërinë shqiptare. Kjo, sepse reforma, përpos profesioneve të drejtësisë të cilat në forma të ndryshme janë prekur prej saj, ka ushtruar një impakt të ndjeshëm në sferën private të çdo qytetari sa i takon marrjes së drejtësisë në kohë, si një nga parimet kryesore të së drejtës: “Drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar”. Reformimi i sistemit të drejtësisë në vend erdhi si një nevojë e diktuar nga dy faktorë: si kusht i vendosur nga Bashkimi Evropian për integrimin e vendit në BE, i artikuluar për shumë vite më rradhë në formën e rekomandimit në Raportet e Progresit të hartuara për Shqipërinë nga Komisioni Evropian, por edhe si një nevojë e natyrshme e diktuar nga rrethanat faktike institucionale dhe shoqërore të vendit. Kjo rezulton qartë në dokumentet analitike dhe strategjike të hartuara dhe miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të reformës në drejtësi. Me Vendimin nr. 14 datë 30.07.2015 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi dokumentin “Analiza e Sistemit të Drejtësisë” (në vijim quajtur “Dokument i Analitik”), ndërsa me Vendimin nr. 15

datë 30.07.2015 të këtij institucioni u miratua dokumenti “Strategjia e reformës në drejtësi në Republikën e Shqipërisë” (në vijim quajtur “Strategjia”).

Dokumenti Analitik, i cili ka shërbyer si një gur themeli dhe ka qenë një busull për Strategjinë, çelet me një tablo mbi perceptimin e publikut lidhur me sistemin e drejtësisë ku ky i fundit cilësohet nga publiku si i prekur thellësisht nga fenomeni i korrupsionit. Ky perceptim negativ lidhet kryesisht me nivelin e ulët të transparencës që karakterizon sistemin gjyqësor.

Kapitulli 2 do të japë një tablo të detajuar mbi faktorët që diktuan nevojën e ndërmarrjes së reformës në drejtësi si dhe synimet kryesore të reformës në raport me sistemin e drejtësisë.

Në kapitullin në vijim jepet një këndvështrim i përgjithshëm mbi procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si një prej shtyllave të reformës në drejtësi dhe një masë konkrete kundër korrupsionit në sistem, procedurat e procesit të rivlerësimit si dhe rezultatet e këtij procesi deri në fund të muajit korrik 2022.

Në studim trajtohet gjerësisht transparencja dhe integriteti si elementë që përshkojnë reformën në sistemin e drejtësisë si lajtmotiv i saj, ndërsa në kapitullin pesë merret në analizë përmbushja e tyre në raport me dispozita konkrete ligjore dhe e ndarë sipas institucioneve të përfshira në sistemin e drejtësisë (organet e qeverisjes së sistemit gjyqësor, gjykata dhe prokurori, si dhe organet e përfshira në procesin e rivlerësimit kalimtar).

2. Faktorët që Kanë Diktuar Reformën në Drejtësi

Ritja e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë në fakt ka qenë një synim kyç i procesit të reformimit të sistemit. Referuar Strategjisë, synimi i reformës në drejtësi ka qenë pikërisht krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili gëzon besimin e publikut dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit, si dhe mundëson integrimin e tij në familjen evropiane. (Kuvendi i Shqipërisë, Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, 2015)

Sa më sipër, (pra synimin e rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë) e ndeshim edhe në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet qëllimi i ngritjes së sistemit të rivlerësimit dhe citohet shprehimisht se: *“Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”*.

Nga analizat ligjore të kryera në kuadër të reformës, rezultoi se sistemi shqiptar i drejtësisë, nuk përmbushte asnjë prej parametrave të parashtruara si synim i reformës në drejtësi. (Kuvendi i Shqipërisë, Analiza e Sistemit të Drejtësisë)

Megjithatë, ajo çka rezulton se ka diktuar në veçanti gjendjen e sistemit të drejtësisë ka qenë:

(i) cilësia e dobët e legjislacionit shqiptar në tërësi, pasi hartimi i këtij të fundit nuk i është nënshtruar një vlerësimi të situatës reale,

kulturës së përgjithshme të shoqërisë shqiptare, rrethanave shoqërore apo faktorëve të tjerë të mgjashëm që formojnë një kontekst të caktuar. Legjislacioni nuk ka marrë parasysh nevojat që paraqet sistemi shqiptar, por ka qenë një më së shumti një transpozim i ligjeve nga sisteme të ndryshme ligjore duke formuar një konglomerat normash dhe modelesh në brendësi të legjislacionit shqiptar që ushtroi ndikim jo të vogël edhe në efikasitetin e sistemit të drejtësisë.

(ii) Një tjetër faktor që ka ndikuar në gjendjen e sistemit të drejtësisë, që ka luajtur dhe një rol kyç në perceptimin e publikut si dhe një nevojën emergjente për të ndër marrë një reformë radikale në sistemin e drejtësisë, ka qenë niveli i lartë i korrupsionit në sistem, i kombinuar me nivelin e ulët të profesionalizmit të funksionarëve të sistemit të drejtësisë. Ky nivel i ulët i profesionalizmit ka ardhur si pasojë e praktikave të padrejta, në shkelje të parimit të meritokracisë për përparimin e funksionarëve të sistemit të drejtësisë në karrierë.

(iii) Përveç sa më sipër, sistemi karakterizohet nga mungesa të thella njohurish kundrejt Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe konventave, traktateve, legjislacionit të zbatueshëm në kuadër të integritimit evropian, jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë si dhe mungësa të thella aftësisht orientuese dhe referuese në këto standarde. Ky element përbën veshitësi në kuadër të integritimit evropian të Shqipërisë pasi e gjen sistemin gjyqësor tërësisht të papërgatitur në këtë drejtim sa i përket

koncepteve, standardeve dhe parimeve të së drejtës evropiane.

Kjo situatë diktoi nevojën emergjente për të ndërmarrë një reformë të thellë, të qëndrueshme, dhe shumëplanëshe në sistemin e drejtësisë, në gjendje që të adresonte sfidat me të cilat përballet sistemi si dhe të garantojë integritimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Përpos synimit të cituar në sipër, reforma ka pasur edhe disa synime specifike lidhur me sistemin e drejtësisë, me qëllim që ky i fundit të kthehej në një sistem:

- të pavarur ndaj çdo lloj ndikimi;
- të paanshëm në funksionimin e tij;
- të përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral dhe profesional në të
- gjitha nivelet strukturore të tij;
- eficient dhe profesional;
- të besueshëm, transparent dhe i aksesueshëm prej publikut;
- bashkëpunues në nivel institucional kur ushet rohet pushteti vendimmarrës për
- emërimin e funksionarëve të lartë të sistemit.

Siç mund të vërehet, trasparenca bën pjesë në synimet specifike të reformës.

Për realizimin me efikasitet të synimeve të saj, reforma në drejtësi u bazua në 7 shtylla bazë që janë:

- I. Sistemi i drejtësisë sipas Kushtetutës dhe Gjykata Kushtetuese
- II. Pushteti gjyqësor
- III. Drejtësia penale
- IV. Edukimi ligjor dhe arsimiti juridik
- V. Shërbimet ligjore dhe profesionet e lira
- VI. Masat në luftën kundër korrupsionit
- VII. Financimi dhe mbështetja infrastrukturore e sistemit

Sipas problematikave të konstatuara nga Dokumenti Analitik, janë përcaktuar për secilën shtyllë një sërë objektivash për t'u përmbushur me qëllim adresimin e tyre dhe garantimin e zbatimit të reformës në drejtësi.

Në këtë këndvështrim, sa i takon shtyllës së dytë që ka të bëjë me pushtetin gjyqësor, dy nga tetë objektivat e përcaktuar për t'u përmbushur në këtë shtyllë kanë në fokus të tyre garantimin e transparencës si një parakusht për rritjen e efikasitetit të sistemit dhe llogaridhënies së funksionarëve të drejtësisë me një synim final pastrimin e sistemit të drejtësisë nga fenomeni i korrupsionit dhe garantimi i integritetit moral dhe profesional të gjyqtarëve në sistem.

3. Procesi i Rivlerësimit në Sistemin Gjyqësor

Për të bërë një tablo të situatës aktuale, është e nevojshme të ndalemi tek shtylla e gjashtë e reformës e cila lidhet me masat anti korrupsion në sistemin gjyqësor. Kjo shtyllë trajton ndër të tjera, gjerësisht nevojën e zbatimit të një procesi rivlerësimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë nga organe të krijuara ad hoc. Sikurse tashmë të gjithë jemi të njohur, objektivat e kësaj shtylle janë përkthyer në dispozita kushtetuese (neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë) si dhe në ligjin që përcakton rregullat e posaçme lidhur me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (në vijim quajtur “Ligji për Rivlerësimin”).

3.1 Organet dhe Subjektet e Përfshira në Procesin e Rivlerësimit në Sistemin Gjyqësor

Bazuar në pragafin 5 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe Ligjit për Rivlerësimin, procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili vepron si shkallë e parë gjyqësore, dhe Kolegji i Posaçëm e Apelit, i cili është organi që shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Gjithashtu bazuar në dispozitat kushtetuese (Nenet B dhe C të Aneksit të Kushtetutës) si dhe në nenin 5 të Ligjit për Rivlerësimin, krahas Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të përfshirë në procesin


e rivlerësimit janë gjithashtu Komisionerët Publikë, të cilët përfaqësojnë interesin publik në proces dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i cili ka rol monitorues dhe mbikëqyrës të procesit.

Sa i takon subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, ato përcaktohen në pikat 3 dhe 4 të nenit 179/b i Kushtetutës, sipas të cilit janë subjekte që i nënshtrohen rivlerësimit të gjithë gjyqtarët (përfshirë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, prokurorët, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (sot Këshilli i Lartë Gjyqësor). Procesit të rivlerësimit i nënshtrohen gjithashtu këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës së Lartë, asaj Kushtetuese, ndihmësit ligjorë prane gjykatave administrative, si dhe ata pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në total numri i subjekteve që i nënshtrohen rivlerësimit është rreth 800 (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2018), ku përfshihen të gjitha kategoritë e përmendura në pragafin e mësipërm.

3.2 Rezultatet e Procesit të Rivlerësimit në Sistemin Gjyqësor

Nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, rezultojnë se deri më 31.07.2022, procesi i rivlerësimit pranë këtij institucioni ka përfunduar për 552 subjekte, të ndara sipas shifrave të pasqyruara në grafikun më poshtë.


Figura 1: Numri i subjekteve për të cilat ka përfunduar rivlerësimi deri më 31.07.2022



Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, 2022

Në grafikun më poshtë janë të pasqyruara shifrat e konfirmimit në detyrë të ndara sipas funksioneve të kryera nga subjekti i konfirmuar.


Figura 2: Numri i subjekteve të konfirmuara në detyrë deri me 31.07.2022



Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, 2022

Shifrat e shkarkimit nga detyra të ndara sipas funksioneve të kryera nga subjekti i rivlerësimit janë të pasqyruar në grafikun më poshtë.


Figura 3: Numri i subjekteve të shkarkuara nga detyra deri më 31.07.2022



Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, 2022

Nga 552 vendime rivlerësimi të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, 157 prej tyre janë ankimuar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit i cili ka lënë në fuqi 120 prej tyre dhe ka ndryshuar, pushuar apo prishur 37 të tjera, shifra të cilat paraqiten grafiksht më poshtë:

Figura 4: Numri i Vendimeve të Ankimuara pranë KPA-së



Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, 2022

4. Elementët Kyç të Reformës në Drejtësi: Transparenca dhe Integriteti

Sikurse është përmendur më sipër, dy prej 8 objektivave të përcaktuar për t'u përmbushur si pjesë e shtyllës së dytë të reformës në drejtësi, përkatësisht asaj që ka të bëjë me pushtetin gjyqësor, janë ngushtësisht të lidhura me garantimin e transparencës si një element kyç për legjitimitetin e tij dhe garantimin e demokracisë. Ajo kontribuon në pavarësinë e gjyqësorit, në njohjen e publikut me veprimtarinë e gjykatave, garanton llogaridhënien, eficientë, integritetin, përgjegjshmërinë dhe integritetin në vendimmarrje, si dhe mund të konsiderohet paradhoma e shumë fenomeneve negative nga të cilat sistemi ynë i drejtësisë ka qenë thellësisht i prekur sikurse është korrupsioni.

Objektivat fokusohen në transparencën e organeve të qeverisjes së gjyqësorit dhe në transparencën e gjykatave.

Më konkretisht objektivi 3 i shtyllës së II-të, përcakton një sërë detyrimesh për organet e qeverisjes së gjyqësorit, ku ndër të tjera mund të nënvizojmë detyrimin për keto organe që të hartojnë një raport vjetor lidhur me veprimtarinë e tyre të cilin ia paraqesin Kuvendit. Kjo është një risi dhe një element i rëndësishëm në garantimin e transparencës, pasi deri në momentin e fillimit të reformës organet e qeverisjes së gjyqësorit nuk e praktikonin diçka të tillë pasi e gjithë anëtarësia e zhvillonte veprimtarinë si pjesë e organit qeverisës me kohë të pjeshme.

Objektivi 5 i shtyllës së II-të përcakton gjithashtu një sërë detyrimesh për gjykatat, që lidhen me transparencën si një tipar dallues i një sistem gjyqësor funksional dhe një demokracie të zhvilluar. Gjithashtu transparenca konsiderohet, përveçse një element i domosdoshëm në garantimin e integritetit profesional të gjyqtarëve dhe

cilësisë në vendimmarrje, edhe një element kontribues në rikthimin e besimit të publikut tek gjyqësori.

Sikurse është përmendur më sipër, ka qenë pikërisht Dokumenti Analitik ai që ka evidentuar problematika në lidhje me transparencën e gjyqësorit të cilat janë materializuar në objektiva të Strategjisë.

Në mënyrë specifike, Dokumenti Analitik ka evidentuar problematika lidhur me mënyrën e zhvillimit të seancave gjyqësore, shpalljen e vendimeve, njoftimin e palëve, afatin e arsyeshëm të zhvillimit të gjykimit, marrëdhënien e gjykatës me publikun dhe median, aksesin në gjyqësor etj.

Sa më sipër, me qëllim adresimin e problematikave të konstatuara, Strategjia ka përcaktuar një sërë masash që synojnë ndër të tjera:

- Rritjen e transparencës së gjykatave, të aksesit të personave privatë në organet e drejtësisë dhe të aksesit të publikut në seancat gjyqësore, si dhe forcimin e marrëdhënieve midis gjykatave, nga njëra anë, dhe medias e publikut, nga ana tjetër, nëpërmjet ndryshimeve në legjislacionin procedural;

- Përmirësimin e cilësisë në arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe dhënien e njëkohshme të arsyetimit me shpalljen e vendimit.

- Vendosijen e detyrimit për publikimin në kohë të vendimeve gjyqësore online;

- Përmirësimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve me publikun në veprimtarinë gjyqësore, hapjen e drejtësisë ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun, si një mjet i rëndësishëm për krijimin e besueshmërisë të gjyqësori.

- Krijimin e zyrave të aksesit në gjyqësor, të cilat do të shërbejnë edhe si instrumente për informimin dhe realizimin e një komunikimi të përditshëm, efektiv e profesional me publikun, medien, grupet e interesit dhe shoqërinë civile.
- Publikimin e raporteve vjetore e periode publike me informacione rreth veprimtarisë së gjykatave.
- Mbështetjen e mjeteve të informimit publik (shtypin, televizionet etj.) për t'u dhënë atyre mundësinë e informimit të shpejtë, profesional, kritik e real të publikut në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë.
- Hartimin e rregullave, praktikave të mira apo linjave udhëzuese që rregullojnë marrëdhëniet e gjyqtarëve e të prokurorëve me mjetet e komunikimit publik dhe individët.

Transparenca e organeve publike është e parashikuar jo vetëm në dokumentet strategjike dhe legjislacionin e reformës në drejtësi, por edhe në objektin dhe qëllimin e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim quajtur "Ligji për të Drejtën e Informimit"). Sipas nenit 1 të këtij ligji, ai ka për qëllim të rregullojë të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.

Konsiderohet autoritet publik në kuptim të nenit 2, pika 1 e Ligjit për të Drejtën e Informimit: *"a) çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) shoqëritë tregtare ku: (i) shteti zotëron shumicën e aksioneve, (ii) ushtrohen funksione publike sipas parashikimit të shkonjës "c" të kësaj pike; (c) çdo person fizik ose juridik të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike".*

Në këtë këndvështrim, institucionet e qeverisjes së pushtetit gjyqësor, ato të rivlerësimit si dhe organet gjyqësore e ato të prokurorisë janë autoritet publik në kuptim të dispozitës së cituar më sipër dhe mbartin detyrimin që të zbatojnë të gjitha parimet, rregullat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj për autoritetet publike.

Ajo çka vlen në mënyrë të posaçme të ndalemi në këtë material është parashikimi i nenit 7 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, i cili përcakton detyrimin për hartimin dhe publikimin e instrumentit të Programit të Transparencës.

Ky instrument nuk është gjë tjetër veçse tërësia e informacionit që një autoritet publik ka për

detyrë ta publikojë në mënyrë proaktive, pra pa kërkesë nga personat e intereuar. Programi i transparencës duhet të ketë në përmbajtje të tij:

- (i) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- (ii) tekstet e plota të legjislacionit të zbatueshëm për fushën në të cilën operon autoriteti publik, strategji apo dokumente të tjera që rregullojnë veprimtarinë e atij autoriteti;
- (iii) informacionin e nevojshëm për depozitimin e një kërkesë për informacion, si për shembull procedura që duhet ndjekur për kërkesën dhe ankimin në rast refuzimi apo mospërgjigje nga autoriteti publik, adresa postare dhe elektronike, vendndodhja, orari i punës së institucionit, të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, procedurat për depozitimin e një kërkesë për informacion;
- (iv) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhenjë përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për vendime;
- (v) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumente që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- (vi) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit;
- (vii) informacion për procedurat e prokurimit apo ato konkurruese të konçesionit/partneritetit publik privat sipas legjislacionit përkatës, duke përfshirë:
 - kontratat e lidhura,
 - shumën e kontraktuar
 - palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara,
 - informacion për zbatimin dhe monitorimin e kontratave si dhe udhëzues e politika të ndryshme
- (viii) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;
- (ix) mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

(x) mekanizmat apo procedurat përmes të cilave personat e interesuar mund ta paraqesin mndimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

(xi) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

(xii) regjistri e kërkesave dhe përgjigjeve sipas nenit 8 të Ligjit për të Drejtën e Informimit

(xiii) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për ti përfituar ato

(xiv) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh

(xv) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik

Synimi i këtij instrumenti është promovimi transparençës proaktive, dhe nëpërmjet saj, i integritetit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

5. Transparenca

Në vijim, me qëllim dhënien e një tabloje sa më të qartë, do të pasqyrojmë, për aq sa është e mundur, për secilin aktor të sistemit të drejtësisë, (sipas kategorisë organ qeverisës dhe/ose gjykatë ose prokurori), nivelin e realizimit të objektivave të vendosura në Strategji lidhur me transparencën, sipas parashikimeve legislative dhe zbatimit në praktikë.

5.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, përcakton rregullat dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Ky ligj merr parasysh dhe vë në zbatim masat e përcaktuara me qëllim realizimin e objektivit 3 të shtyllës së II-të të Strategjisë “Mirëqeverisja e gjyqësorit në funksion të pavarësisë, përgjegjshmërisë, eficiencës dhe transparencës së tij”. Ajo çka duhet përmendur pikë së pari me qëllim që të kuptohet ndryshimi i emërimit të përdorur në Strategji dhe atij që gjejmë të reflektuar në ligj në raport me organin qeverisës të gjyqësorit, është fakti se ligji ka marrë në konsideratë nevojën për organizimin e KLD-së¹ në dy dhoma, përkatësisht: Këshilli për Gjyqësorin dhe Këshilli për Prokurorinë, me kompetenca të ndara përkatësisht për gjyqtarët dhe prokurorët; Ndër të tjera, ligji reflekton masat e propozuara në Strategji lidhur me:

- parashikimin që ministri i Drejtësisë dhe Presidenti të mos jenë në përbërje të KLD-së;
- parashikimin që Këshilli i Lartë i Drejtësisë do ta zgjedhë vetë kryetarin e tij;

- parashikimin që anëtarët e KLD-së të ushtrojnë me kohë të plotë funksionin e tyre dhe të kthehen në pozicionin e mëparshëm pas përfundimit të mandatit;

- funksionimin e KLD-së me tri komisione permanente (pavarësisht sistemit një- ose dydhomësh), përkatësisht: Komisioni Disiplinor, Komisioni i Vlerësimit të Karrierës dhe Komisioni i Administrimit, që do të kenë kompetenca të plota vendimmarrëse në fushat përkatëse dhe ankimet kundër vendimeve të tyre do të shqyrtohen në mbledhjen plenare të KLD-së;

- përcaktimin e rregullave të qarta procedurale për të gjitha proceset që kryen KLD-ja për të siguruar një proces vendimmarrës transparent;

- Krijimin e mundësive që strukturat përgjegjëse për qeverisjen e gjyqësorit të kenë kapacitetet e duhura për zhvillimin e politikave dhe të strategjive të sektorit.

- Suprimimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare.

- Vendosjen, si rregull, të hartimit të detyrueshëm të raporteve të veprimtarisë vjetore për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë dhe Prokurorin e Përgjithshëm, që do t'i paraqesin përpara Kuvendit dhe opinionit publik, bazuar në modelet përkatëse evropiane në këtë fushë.

Nga përmbajtja e faqes zyrtare në internet të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vërehet një angazhim serioz kundrejt transparencës së aktivitetit të këtij institucioni. Në këtë këndvështrim, në përputhje me dispozitat e ligjit të posaçëm, dhe më konkretisht me nenin 69 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka të publikuar në faqe vendimmarjen e tij në formë procesverbali me shkrim dhe në versionin audio. Pikat 2

¹Këshilli i Lartë i Drejtësisë, organi kompetent për qeverisjen e gjyqësorit deri në momentin e miratimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, i përmendur në Strategjinë e reformës në Sistemin e Drejtësisë

dhe 3 të nenit 69 përcaktojnë që: *“Përpara publikimit, nën përgjegjësinë e kryetarit, administrata kujdeset për redaktimin e materialit, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.”*

I njëjti parashikim zbatohet qoftë në raport me regjistrimin audio, ashtu edhe lidhur me atë në formë procesverbali.

Të njëjtën linjë mban dhe neni 98 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, pika 2 e të cilit përcakton se: *“Aktet administrative individuale të Këshillit, në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë, bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Kjo praktikë publikimi nuk është në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit dhe nenin 4, pika 4, gërma (b) e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, sipas të cilit *“Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publikë zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre.”* Pikërisht për të nxitur dhe rritur integritetin dhe transparencën e institucioneve lidhur me zyrtarët e tyre, ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, e ka përjashtuar nga fusha e tij e zbatimit informacionin lidhur me veprimtarinë administrative të zyrtarëve publikë. Për këtë arsye, çdo informacion i pasqyruar në aktet administrative individuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që a priori ka të bëjë me veprimtarinë publike të gjyqtarëve, duhet të jetë i publikuar pa filtra dhe kufizime. Duhet të jetë vetë Këshilli, që rast pas rasti, nëse konstaton se në parashkrimin e çështjes, preken elementë që do të çënonin privatësinë, dinjitetin apo të dhënat sensitive të gjyqtarit, ta kufizojë atë pjesë të informacionit, por në çdo rast identiteti i gjyqtarit nuk mund t'i nënshtrohet rregullave të privatësisë për aq sa pasqyrohet veprimtaria e tij publike.

Në vitin 2019 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka adresuar Këshillit të Lartë Gjyqësor Rekomandimin nr. 55 datë 30.10.2019 për

zbatimin me korrektësi të instrumentit të Programit të Transparencës.

Nga sa konstatohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky i fundit ka publikuar ikonën e Programit të Transparencës në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit, dhe formatin e programit model të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, ndryshuar me Urdhërin nr. 35 datë 31.03.2021 “Për një ndryshim në Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”.

5.2 Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Dispozitat e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, lidhur merregullat dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë janë të zbatueshme në mënyrë të njëjtë edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, sikurse edhe masat e përcaktuara me qëllim realizimin e objektivit 3 të shtyllës së II-të të Strategjisë “Mirëqeverisja e gjyqësorit në funksion të pavarësisë, përgjegjshmërisë, eficiencës dhe transparencës së tij”.

Në përputhje me dispozitat e ligjit të posaçëm, dhe më konkretisht me nenin 167 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka të publikur në faqe vendimmarjen e tij në formë procesverbali më shkrim dhe në versionin audio. Pikat 2 dhe 3 të nenit 167 përcaktojnë që:

“Përpara publikimit, nën përgjegjësinë e kryetarit, administrata kujdeset për redaktimin e materialit, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.”

I njëjti parashikim zbatohet qoftë në raport me regjistrimin audio, ashtu edhe lidhur me atë në formë procesverbali.

Njëjtë si në rastin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, trajtur më lart në këtë material, të njëjtën linjë mban dhe neni 190 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, pika 2 e të cilit përcakton se:

“Aktet administrative individuale të Këshillit, në lidhje me statusin e prokurorëve ose nëpunësve

civilë të prokurorisë, bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

I njëjti konstatim dhe vlerësim si për rastin e Këshillit të Lartë Gjyqësor vlen edhe lidhur me këtë praktikë publikimi të ndjekur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë të diktuar nga ligji i posaçëm. Në vitin 2019 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka adresuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë Rekomandimin nr. 54 datë 30.10.2019 për zbatimin me korrektësi të instrumentit të Programit të Transparencës.

Nga sa konstatohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ky i fundit ka publikuar ikonën e Programit të Transparencës në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit, dhe formatin e programit model të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 "Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar", ndryshuar me Urdhërin nr. 35 datë 31.03.2021 "Për një ndryshim në Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 "Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar", duke treguar një angazhim serioz kundrejt garantimit të transparencës dhe aksesit të publikut në informacionin e administruar dhe prodhuar nga ky institucion.

Vlen të përmendet që, përveç Rekomandimit të cituar më sipër lidhur me publikimin dhe zbatimin e programit të transparencës, organet e qeverisjes së sistemit gjyqësor, nuk kanë qenë objekt vendimmarrje nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çka përbën një tregues të mëtejshëm për angazhimin e tyre kundrejt këtij standardi të përcaktuar, jo vetëm si një detyrim që buron nga kuadri ligjor, por edhe si një synim i reformës në drejtësi për garantimin e integritetit të sistemit të drejtësisë dhe rikthimit të besimit të publikur në të.

5.3 Gjykatat

Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", përcakton parimet dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të gjykatave në Shqipëri. Ky ligj merr parasysh dhe vë në zbatim masat e përcaktuara me qëllim realizimin e objektivit 5 të shtyllës së II-të të Strategjisë "Garantimi i transparencës së pushtetit gjyqësor dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në përputhje me standardet evropiane."

Kjo evidentohet më së miri nga përmbajtja e nenit 5, pika 4 e të cilit përcakton se: "Gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase."

Po ashtu, pika 2 e nenit 7 përcakton se: "Të gjitha organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, bashkëpunojnë për të garantuar që pushteti gjyqësor të jetë i pavarur, efikas, i besueshëm dhe transparent." Integriteti përmendet në pikën 1 të nenit 8 të ligjit ku citohet se: "Veprimtaria e shërbimit civil gjyqësor rregullohet me ligj dhe bazohet mbi parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve eficiente dhe të aksesueshme për çdo person." Siç mund të evidentohet parimi i transparencës dhe integritetit përbëjnë lajtmotivin dhe thelbin e mënyrës së të vepruarit të gjykatave.

Neni 46 i këtij ligji përcakton ndër të tjera se: "Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që:... d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin."

Po ashtu, neni 47 i tij përcakton se detyrimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit për mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Në fakt qasja në informacionin e gjykatave është një çështje e cekur dhe e rregulluar edhe në ligjin 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i

ndryshuar, neni 91 i të cilit përcakton ndër të tjera detyrimin e Këshillit për të:

Në përputhje me detyrimin e përmendur në nenin 91, është krijuar portali www.gjykata.gov.al ku secila gjykatë e çdo juridiksioni ka hapësirën e saj. Ajo çka konstatohet është se gjykatat publikojnë në portal një përmbledhje të vendimit gjyqësor, dhe jo vendimin e plotë të anonimizuar sipas akteve nënligjore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sikurse është përmendur edhe më lart, transparenca në fushën e pushtetit gjyqësor, një element i të cilës është edhe publikimi i vendimmarjes së gjykatës, është një element kyç për legjitimitetin e pushtetit gjyqësor dhe garantimin e demokracisë. Ajo ndikon në uljen e korrupsionit, në pavarësinë e gjyqësorit, në njohjen e publikut me veprimtarinë e gjykatave si dhe garanton llogaridhënien e transparencën në dhënien e drejtësisë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që duhet pasur parasysh në publikimin e vendimeve gjyqësore është nevoja dhe interesi që ky aspekt paraqet në lidhje me të drejtën e çdo profesionisti të fushës së drejtësisë për tu njohur me praktikën gjyqësore për arsye që lidhen me ushtrimin e profesionit, kërkimore apo të një natyre tjetër.

Sa i takon transparencës së gjykatave nga pikëpamja e Ligjit për të Drejtën e Informimit, tregues për këtë element kemi konsideruar vendimarrjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku vërehet se qw nga 2016², ky i fundit ka marrë një sërë vendimesh kundrejt gjykatave të ndryshme sa i takon dhënies së aksesit në informacion publik. Nga përmbajtja e Vendimeve të Komisionerit vërehet se informacioni i kërkuar gjatë viteve të para kishte të bënte kryesisht me informacion të natyrës administrative (përbërja e strukturës, organika e gjykatës), ndërsa ajo që vërehet së fundmi është që kërkesat për informacion i referohen kryesisht pajises me vendime të gjykatave. Ky është një tregues i mëtejshëm i faktit se masat e përcaktuara në zbatim të objektivave të Strategjisë, si dhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm të hartuar mbi bazën e Strategjisë, që

kanë të bëjnë me publikimin online të vendimeve të gjykatës, ende nuk gjejnë zbatim. (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendime 2016, 2017, 2018, 2021, 2022).

5.4 Prokuroritë

Sikurse në rastin e gjykatave, edhe për prokurorinë, tregues i nivelit të transparencës, do të konsiderohet vendimarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kundrejt këtij institucioni. Në këtë këndvështrim, duke filluar që nga viti 2015³, ky i fundit ka marrë një sërë vendimesh kundrejt prokurorive të ndryshme sa i takon dhënies së aksesit në informacion publik. Siç mund të evidentohet nga objekti i vendimmarjes së Komisionerit, ankesat ndaj organit të prokurorisë kanë të bëjnë kryesisht me vënien në dispozicion të vendimeve të prokurorisë lidhur me fillimin ose pushimin e ndjekjes penale dhe/ose kallëzimet e depozituara në prokurori. (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendime 2016, 2017, 2018, 2021) Duke qenë se vendimet e prokurorisë nuk publikohen në asnjë portal elektronik sikurse në rastin e gjykatave, dhe as nuk ekziston në legjislacion një parashikim për publikimin e tyre, në ndryshimet e hartuara nga Zyra e Komisionerit në lidhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit, ku janë marrë parasysh të gjitha problematikat e konstatuara nga zbatimi në praktikë i këtij ligji, si dhe sugjerimet e shoqërisë civile, vendimet e prokurorisë u propozuan të përfshihen në programin e dedikuar të transparencës për organin e prokurorisë në versionin fillestar të ndryshimeve të ligjit për të drejtën e informimit, propozime të cilat nuk u pasqyruan në draft sipas konsultimit me Ministrinë e Drejtësisë.

Gjithashtu gjatë vitit 2022, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dhënë Rekomandime për të gjitha prokuroritë, përfshirë ato të Përgjithshme, në lidhje me publikimin dhe zbatimin e programit të transparencës. (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Rekomandime 2022).

² Struktura e të drejtës së informimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u bë funksionale në vitin 2015

³ Ky vit përkon me bërjen funksionale të struktures së të drejtës së informimit pranë Zyrës së Komisionerit.

5.5 Institucionet e Rivlerësimit

Pavarësisht se sa më sipër janë aktorët afatgjatë të qeverisjes së sistemit të drejtësisë apo të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në dhënien e drejtësisë, një gjurmë të rëndësishme në procesin e reformës kanë dhe kanë pasur gjatë këtyre viteve edhe organet e rivlerësimit.

Për këtë arsye vlen të përmendet qasja e këtyre organeve ndaj transparencës, si një objektivi kyç në këtë proces. Po ashtu duke qenë se Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes e të Dhënave është investuar gjerësisht që nga nisja e procesit të rivlerësimit në garantimin e transparencës në këtë proces, vlen të ndalemi edhe tek ky aspekt.

Nga konsultimi i faqes zyrtare të Komisionerit, konstatohen një sërë vendimesh kundrejt Komisionit të Pavarur të Kualifikimit si dhe organeve të tjera të përfshira në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Vendimarrja e Komisionerit në raport me çështje që lidhen drejtpërsëdrejti me reformën daton me fillimin e saj. (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

Vendime 2018)

Po ashtu Komisioneri ka dhënë një sërë opinione në favor të institucioneve që me ligj janë përfshirë në procesin e rivlerësimit apo në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të rivlerësimit. (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhënie Mendimi 2017, 2018, 2020)

Komisioneri është institucioni të cilit me ligj i është dhënë tagri për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit nga njëra anë dhe mbrojtjen e të dhënave personale nga ana tjetër. Si i tillë ai duhet të bëjë edhe balancën midis këtyre të drejtave kushtetuese duke vendosur edhe përparësitë rast pas rasti. Nga vendimarrja si dhe opinionet e dhëna nga ana e Komisionerit vërehet angazhimi dhe qasja e tij në favor të transparencës, duke e vlerësuar atë si një element që kontribuon në integritetin e procesit, ndryshimin e perceptimit të publikut kundrejt sistemit të drejtësisë si dhe përmbushjen e pritshmërisë së tij në raport me reformën në sistemin e drejtësisë.

6. Gjetjet Kryesore

Reforma në drejtësi konsiderohet një vademecum për fenomenet negative nga të cilat është i prekur vendi ynë, pasi është e qartë që pandëshkueshmëria është burimi dhe ushqimi i fenomeneve një prej të cilëve është edhe korrupsioni.

Ky fenomen ka ndikuar negativisht jo vetëm në sferën private të qytetarëve të cilët kanë kërkuar drejtësi përpara gjykatave shqiptare, por edhe në ekonominë e vendit, pasi dihet që një sistem drejtësie i prekur nga korrupsioni shërben si arsye për të mbajtur larg investimet e huaja.

Megjithatë, derisa ky efekt agatgjatë i zbatimit të reformës të bëhet i prekshëm me përfundimin e procesit të saj, disa efekte anësore me impakt negativ të cilat bëhen pengesë për dhënien e drejtësisë dhe transparencën e veprimtarisë së sistemit, do të jenë të pranishme.

Një prej këtyre efekteve negative diktohet nga numri i lartë i gjyqtarëve dhe prokurorëve të larguar nga procesi i rivlerësimit kalimtar. Ajo çka vërehet nga shifrat e pasqyruara në grafiket e paraqitura në faqen 6 më sipër, është fakti se nga 552 subjekte për të cilat ka përfunduar procesi i rivlerësimit deri më tani, pothuajse gjysma e tyre

janë larguar nga sistemi, çka ka krijuar një mungesë të ndjeshme të numrit të gjyqtarëve të mbetur në sistem. Kjo mungesë sjell si pasojë mbingarkesë për gjyqtarët e mbetur ne detyrë dhe rrjedhimisht pamundësi në dhënien e drejtësisë brenda afateve të kërkuara dhe sipas cilësisë së kërkuar. Nëse marrim parasysh numrin e magjistratëve që formohen çdo vit në Shkollën e Magjistraturës, do të duhen vite derisa boshllëku i krijuar të rekuperohet me zyrtarë të rinj të drejtësisë.

Po ashtu mungesat e burimeve njerëzore në gjykata, siç rezultojnë në mënyrë të tërthortë në vendimmarjen e Komisionerit të shqyrtuar për hartimin e këtij materiali kanë sjellë si pasojë pamundësinë e gjykatave për të anonimizuar vendimet duke shkaktuar pasojë negative mbi transparencën në veprimtarinë e tyre.

Kjo pamundësi, si dhe qasja me raste refuzuese e organeve të rivlerësimit kundrejt transparencës (siç mund të vërehet edhe nga vendimmarja e Komisionerit) mund të ketë një impakt negativ në atë që është synimi kyç i reformës, pra rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Referenca

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 2019: Rekomandime, Rekomandim nr. 55 datë 30.10.2019, URL: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://www.idp.al/wp-content/uploads/2019/11/Rekomandim_nr_55_KLGJ.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 2019: Rekomandime, Rekomandim nr. 54 datë 30.10.2019, URL: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://www.idp.al/wp-content/uploads/2019/11/Rekomandim_nr_54_KLP.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 53 datë 29.08.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/Vendim_53_gjykata_rrethit_gjyqesor_Kukes.pdf;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 55 datë 29.08.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/Vendim_55_gjykata_rrethit_gjyqesor_Diber.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 57 datë 30.08.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/Vendim_57_Gjykata_rrethit_gjyqesor_Lezhe.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 58 datë 30.08.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/Vendim_58_Gjykata_apelit_Tirane.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 60 datë 31.08.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/Vendim_60_Gjykates_Administrative_te_shkalles_se_pare.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 86 datë 24.11.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/vendim_86.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 24 datë 13.02.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_nr_24-Gjykata_e_rrethit_gjyqesor_Shkoder.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 34 datë 20.02.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_nr_34-Gjykata_e_Apelit_Tirane.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 65 datë 18.04.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/04/Vendim_nr_65-Gjykata_e_rrethit_gjyqesor_Durres.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 96 datë 08.11.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/11/Vendim_nr_96-Gjykata_e_Rrethit_Gjyqesor_Shkoder.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 107 datë 26.12.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim_nr_102-Prokuroria_prane_Gjykates_se_Shkalles_se_Pare_Kruje.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 2 datë 29.01.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/01/Vendim_nr_02-Gjykata_RrGj_Elbasan.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 29 datë 05.07.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendim_nr_29-Gjykata_RrGj_Tirane.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 48 datë 04.10.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/10/Vendim_nr_48-Gjykata_RrGj_Tirane.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 5 datë 17.02.2021, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim_nr_05_GjRGjT.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 8 datë 19.02.2021, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim_nr_08_GjRrGjV.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 25 datë 10.05.2021, URL: <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/05/Gjyka-ta-e-Posa%C3%A7me-e-Shkalles-s%C3%AB-Par%C3%AB-p%C3%ABr-Korrupsionin-dhe-Krimin-e-Organizuar-1.pdf>
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 38 datë 11.08.2021, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/08/vendimi_nr_38_ddi.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 49 datë 12.11.2021, URL: <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/01/Vendim-49.pdf>
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 2 datë 28.02.2022, URL: <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim-2.pdf>
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 9 datë 23.01.2015, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/vendim_09_pp.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 33 datë 13.05.2015, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/vendim_33_pmat.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 59 datë 31.08.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/Vendim_59_Prokuroria_e_pergjithshme.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 88 datë 25.11.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_88_Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 89 datë 25.11.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_89_Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 90 datë 25.11.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_90_Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 91 datë 30.11.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_91_Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 92 datë 30.11.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_92_Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 93 datë 30.11.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_93_Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 94 datë 05.12.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/vendim_33_pmat.pdf

tent/uploads/2017/02/Vendim_94_Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 95 datë 05.12.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Vendim_95_Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 96 datë 12.12.2016, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/vendim_96.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 48 datë 13.03.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/Vendim_nr_48-Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 49 datë 15.03.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/Vendim_nr_49-Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 63 datë 14.04.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/04/Vendim_nr_63-Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 84 datë 27.06.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/06/Vendim_nr_84-Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 88 datë 18.09.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/09/Vendim_nr_88-Prokuroria_e_Pergjithshme.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 102 datë 26.12.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/12/Vendim_nr_102Prokuroria_prane_Gjykates_se_Shkalles_se_Par

e_Kruje.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 3 datë 29.01.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/01/Vendim_nr_03-Prokuroria_GJSHP_Tirane.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 24 datë 19.06.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/06/Vendim_nr_24-PpGjShPT.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 45 datë 31.07.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendim_nr_45-PPGjShPT_O.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 3 datë 16.02.2021, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim_nr_03_PGjShPT.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Rekomandime 2022, URL: <https://www.idp.al/rekomandime-2022-ddi/>

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 4, datë 05.02.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/Vendim_nr_04-DSIK.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 5, datë 05.02.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/Vendim_nr_05-ILDKPKI.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 14, datë 26.03.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/03/Vendim_nr_14-KPK.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 71, datë 04.12.2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/12/Vendim_nr_71_DSIK.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 21,

datë 10.07.2020, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendim_nr_21_KPK.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Vendim nr. 54, datë 07.12.2021, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/12/vendimi_nr_54_ddi_kpk_2021.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhënie Mendimi Mars 2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/04/05_Dhenie_mendimi_avokatit_te_popullit.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhënie Mendimi 27.06.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/06/13_Dhenie_Mendimi_Kuvendi.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhënie Mendimi 28.06.2017, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/06/14_Dhenie_Mendimi_Kuvendi.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhënie Mendimi Prill 2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/04_Dhenie_mendimi_Vodafone_KPK.pdf

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhënie Mendimi Dhjetor 2018, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/04/12_Dhenie_mendimi_KPK.pdf

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhënie Mendimi 2020, URL: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/06/15_Dhenie_mendimi_AP.pdf

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, 2022, URL: <https://kpk.al/statistika/>

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

- Kuvendi i i Republikës së Shqipërisë, 2013: Raporti Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2013, URL: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgicclcfndmkaj/https://www.parlament.al/Files/Integrimi/2013_progress_repo

rt_en_23393_1-1.pdf

- Kuvendi i i Republikës së Shqipërisë, 2014: Raporti Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2014, URL: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgicclcfndmkaj/https://www.parlament.al/Files/Integrimi/al_report_june_2014_en_23395_1-2.pdf

- Kuvendi i i Republikës së Shqipërisë, 2015: Raporti Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2015, URL: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgicclcfndmkaj/https://www.parlament.al/Files/Integrimi/20151110_report_al_bania-1.pdf

- Kuvendi i i Republikës së Shqipërisë, Analiza e Sistemit të Drejtësisë, 2015, Vëllimi i Parë, Pjesa e dytë, miratuar me Vendimin nr. 14 datë 30.07.2015 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2015, Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin nr. 15 datë 30.07.2015 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2016: Raporti Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016, URL: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgicclcfndmkaj/https://www.parlament.al/Files/Integrimi/20161109_report_al_bania.pdf

-Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar

- Ligji nr. 119.2014 “Për të drejtën e informimit”

- Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar



Fondazioni Qemal Stafa

www.fqs.al
secretary@fqs.al